



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 26.09.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.07.2019, 23.07.2019, 26.07.2019, 30.07.2019 dhe 11.09.2019.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
6. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
7. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
8. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
10. *Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
11. *Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
12. *Charles Ericksen, USAID.*
13. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
14. *Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
15. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.07.2019, 23.07.2019, 26.07.2019, 30.07.2019 dhe 11.09.2019.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje të gjithëve!

Siç jeni vënë në dijeni, po fillojmë mbledhjen e datës 26 shtator 2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Duke përfituar nga prezenca dhe nga interesi i medias lidhur me procesin e funksionalizimit të Gjykatës së Lartë, dëshiroj t'ju bëj me dije që Këshilli, në mbledhjen e kaluar, ka hapur 1 vend vakant për anëtar të Gjykatës së Lartë dhe prandaj përfitojmë nga rasti t'i bëj thirrje të gjithë atyre që plotësojnë kriteret ligjore.

Ky është një moment i shumëpritur për të gjithë ato juristë që kanë kontribute profesionale dhe akademike. Është një moment historik, ku ne kemi mundësi të gjithë së bashku t'ia nisim nga e para duke krijuar Gjykatën e Lartë, prandaj kemi nevojë për njerëz të përkushtuar, për profesionistët më të lartë. Ju lutem, aplikoni!

Tani, le të kalojmë tek rendi i ditës.

Siç jeni vënë në dijeni për sa i përket çështjeve për rendin e ditës sot, që kërkohet vendimmarrja nga ana e Këshillit, janë 4 çështje në rendin e ditës. Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjes pararendëse që Këshilli ka zhvilluar. Çështja e dytë ka të bëjë me caktimin e një anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përbërjen e Komisionit për Mbrojtjen e Magjistratëve. Çështja e tretë ka të bëjë me vlerësimin nga ana e Këshillit të statusit të inspektorëve që kanë punuar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Dhe çështja e katërt është dhënia nga ana e Këshillit të një mendimi lidhur me kandidatët që kanë aplikuar në pozicionin e pedagogut të brendshëm të Shkollës së Magjistraturës.

Përpara se të kalojmë në shqyrtimin e këtyre çështjeve, siç kemi bërë praktikë, kamerat mund të vazhdojnë të dalin jashtë dhe ftohen të gjithë gazetarët të jenë të pranishëm për të ndjekur mbledhjen e Këshillit.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes, ndërsa gazetarët largohen gjatë shqyrtimit të pikës së tretë të rendit të ditës.)

Atëherë, më konkretisht, pika e parë ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 19.07.2019, 23.07.2019, 26.07.2019, 30.07.2019 dhe 11.09.2019.

Të gjithë jemi njohur me materialet dhe procesverbalet që ju janë përcjellë në rrugë elektronike nga administrata e Këshillit. Deri më sot nuk kemi pasur komente apo sugjerime për ndryshim. Për rrjedhojë ju ftoj që t'i votojmë procesverbalet për miratim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord, me sqarimin që për të parin, të dytin dhe të pestin unë kam qenë prezent. Dy të tjerët nuk kam qenë prezent, kështu që nuk votoj për ato.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 26.09.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përbërje të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Fatmira Luli* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 9. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
- 11. Charles Ericksen, USAID.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*
- 14. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përbërje të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimin dhe Buxhetin.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë lidhur me caktimin e një anëtari të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përbërjen e Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve (magjistratëve).

Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni për Planifikimin Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe do raportohet prej meje (Kryetares).

Siç jeni në dijeni, Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 564, datë 31.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë

ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”. Ky vendim, ka dalë në zbatim të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në fakt ky vendim ka përcaktuar rregullat dhe procedurën që do ndiqen për mbrojtjen e magjistratit duke pasur si objektiv kryesor konsolidimin e garancive të statusit të magjistratit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrës.

Vendimi në pikën 7 të tij ka përcaktuar ngritjen e Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përbërjen e të cilit një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor, një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Kryetari i Gjykatës pranë së cilës ushtron detyrën gjyqtari, për të cilin kërkohet mbrojtje.

Në këto kushte, për të bërë menjëherë efektiv këtë Komision, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të caktojë sot një nga anëtarët e tij, që njëkohësisht do të jetë edhe kryetari i Komisionit.

Menjëherë, me caktimin e tij nga KLGJ-ja, kryetari i Komisionit do të vijojë me ushtrimin e veprimtarisë së nevojshme duke marrë masat e duhura për të garantuar mbështetjen organizative dhe administrative për realizimin e funksionit të Komisionit.

Në këto kushte, ju ftoj që të propozoni një anëtar të cilin ne duhet ta votojmë për të qenë anëtar në përbërjen e këtij Komisioni.

Ka ndonjëri prej jush propozim?

Brikena Ukperaj: Atëherë, faleminderit zonja Kryetare!

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka ky Komision, duke marrë parasysh eksperiencën e veçantë që duhet të ketë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor në kryesimin por edhe në organizimin e mbledhjeve të Komisionit, i cili funksionon pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, unë do të propozoja zotin Bici, duke qenë se është edhe përfaqësues i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ka një eksperiencë pune pothuajse më të madhe nga të gjithë ne dhe ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë, gjyqtar i apelit të krimeve të rënda, gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe mendoj që figura e tij dhe vetë vjetërsia në profesion, përvoja është më se e mjaftueshme dhe e nevojshme jo vetëm për të qenë anëtar i këtij Komisioni por edhe për të qenë kryetar i këtij Komisioni.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë propozim tjetër?

Jo!

Kalojmë në votim të propozimit të bërë nga zonja Ukperaj?

Atëherë, zonja Ukperaj faleminderit për propozimin. Hedhim në votim propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, që zoti Bici të jetë anëtar dhe kryesisht edhe kryetar i Komisionit të Mbrojtjes së Gjyqtarëve, për një mandat 2-vjeçar.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Po e pranoj. Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e zotit Medi Bici si anëtar, njëkohësisht kryetar, i Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, për një mandat dyvjeçar.

Ngarkohet Kryetari i Komisionit, për të kërkuar nga institucionet e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.07.2019, caktimin e përfaqësuesve të tyre në përbërje të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor garanton mbështetjen e duhur organizative dhe administrative për realizimin e funksionit të Komisionit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 26.09.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimin të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Fatmira Luli* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 9. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
- 11. Charles Ericksen, USAID.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i Raportit “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimin të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen e tretë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e raportit dhe lipset vendimmarrje, “Për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, material i cili është përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimin të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe kryetari i këtij Komisioni, zoti Medi Bici e ftoj që të na bëjë relatimin e raportit dhe propozimet përkatëse.

Medi Bici: Në zbatim të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62/14 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes vendore të sistemit të drejtësisë” dhe nenit 168 të ligjit nr. 168/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 59, datë 24.04.2019 ngriti Komisionin e Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka për të përmbushur detyrat si më poshtë:

“Komisioni i Përkohshëm, për të përmbushur detyrën e tij duhet të shqyrtojë dosjet personale të Kryeinspektorit dhe secilit inspektor, duke evidentuar të dhënat individuale të tyre si: historinë e arsimimit të tyre; vjetërsinë në ushtrimin e detyrës si gjyqtar ose si jurist; emërimin për herë të parë, si inspektor pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë; gjykatën nga e cila kanë ardhur ose institucionin apo profesionin që kanë ushtruar para se të emërohen si inspektor; për inspektorët të cilët nuk kanë ardhur nga gjykatat të evidentohet shkaqet për të cilat ato kanë ndërprerë marrëdhëniet me gjyqësorin; numrin e mandateve si inspektor, evidentimin e emërimin të fundit si inspektor dhe mbarimin tij; detyrën që kanë ushtruar inspektorët, bazuar në urdhrat e titullarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për ndarjen në seksione të inspektoratit; inspektorët të cilët i janë nënshtruar testimit profesional të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës; të dhëna për masa disiplinore; çdo të dhënë tjetër që ndodhet në dosjen e inspektorit dhe që ndihmon në përmbushjen e qëllimit të Komisionit.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në historikun profesional, Komision harton një raport për Këshillin, në të cilin duhet të evidentojë: inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve; inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve; inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzojnë këtë status; inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit; inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet;

dhënia e pëlqimit nga secili inspektorë për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Raporti i EURALIUS-it rekomandon se:

Rekomandohet që KLGJ të krijojë një Komision të Përkohshëm, i cili do të analizojë të dhënat dhe do t'i paraqesë Këshillit propozimet respektive mbështetur në profilin individual të secilit inspektor. Në përpurthje me të shkuarën profesionale të secilit inspektor, Komisioni i Përkohshëm do të vendosë se kush ka punuar kryesisht me vlerësimin profesional dhe kush me çështjet disiplinore, kush ka statusin e magjistratit dhe kush nuk e ka statusin e magjistratit. Komisioni duhet të shqyrtojë çështjet si me poshtë:

1. Në një situatë kur KLGJ-ja është krijuar dhe ILD-ja nuk është krijuar ende, cili duhet të jetë statusi, roli dhe funksionet e inspektorëve që do të transferohen tek ILD-ja sipas ligjit? A duhet të bëhen pjesë e administratës së KLGJ-së që sapo është krijuar? Nëse po, duhet të vazhdojë si strukturë e veçantë (më vete)? A është e nevojshme që të merret një vendim i posaçëm për transferimin e përkohshëm të atyre inspektorëve dhe kush duhet ta marrë një vendim të tillë?

2. Duke pasur parasysh faktin se aktualisht Shqipëria nuk ka një institucion kompetent për të kryer hetimet disiplinore ndaj gjyqtarëve (pasi ILD-ja nuk është krijuar ende dhe KLGJ-ja nuk ka më kompetencë të tillë) si dhe kush duhet të procedojë me ankesat e reja në lidhje me shkeljet disiplinore të gjyqtarëve? Si dhe kush duhet të procedojë me hetimet disiplinore të mbetura pezull dhe ato të reja?

3. Duke marrë në konsideratë se Gjykata Kushtetuese në vitin 2017 ka shfuqizuar të gjitha dispozitat për shkeljet disiplinore (nenet 100-104, ligji për Statusin), dhe në mungesë të dispozitave të reja të miratuara nga Kuvendi, a është e mundur që të përdoret bazë tjetër ligjore (p.sh. dispozita ligjore, të përfshira në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, etj.) për hetime disiplinore dhe sanksione disiplinore? A është kjo qasje në përpurthje me parimet themelore të Shtetit të së Drejtës dhe procesin e duhur?

Mbështetur në analizën më sipër, mund të konkludojmë se transferimi i përkohshëm i Kryeinspektorit dhe inspektorëve të tjerë në KLGJ ka një karakter kompleks: Të gjitha aktivitetet që lidhen me vlerësimin profesional do të kryhen sipas

udhëzimeve dhe mbikëqyrjes së KLGJ-së. Të gjitha aktivitetet që lidhen me hetimin disiplinor do të vazhdojnë të kryhen nën mbikëqyrjen e Ish-Kryeinspektorit.

Konkluzionet e Misionit EURALIUS janë:

Konkluzione në lidhje me ndërveprimin institucional dhe funksional dhe vazhdimësinë institucionale: Kryeinspektori dhe të gjithë inspektorët e ish-Inspektoratit të KLD-së do të transferohen në KLGJ pas krijimit të KLGJ-së; Inspektorët që kanë punuar kryesisht për vlerësimin e performancës do të konsiderohen si të komanduar ex lege në Këshillin e Lartë Gjyqësor; Kryeinspektori dhe inspektorët e tjerë magjistratë që kanë punuar kryesisht për hetime disiplinore do të konsiderohen të transferuar përkohësisht në KLGJ deri në krijimin e ILD-së; Inspektorët e komanduar ex lege në KLGJ do të kenë statusin e “inspektorëve” dhe mund të vazhdojnë punën për vlerësimin e performancës dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të gjyqtarëve; Gjatë periudhës kalimtare në KLGJ, Kryeinspektori dhe inspektorët magjistratë që kanë punuar kryesisht për çështjet disiplinore mund të vazhdojnë të punojnë për shqyrtimin e ankesave që lidhen me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Për sa i takon kompetencave që lidhen me hetimet disiplinore ndaj gjyqtarëve, rekomandohet që KLGJ të parashtrijë pyetjet e shpjeguara në pjesën narrative të këtij shënimi tek Komisioni i Venecias (shiko më sipër); Rekomandohet që KLGJ-ja të krijojë një Komision të Përkohshëm, i cili të analizojë të dhëna dhe të hartojë për Këshillin propozimet përkatëse mbështetur në profilin individual dhe dosjen personale të çdo inspektori. Në përputhje me historikun profesional të çdo inspektori Komisioni i Përkohshëm do të vendosë se kush ka punuar kryesisht për vlerësimin e performancës dhe kush ka punuar për çështjet disiplinore, kush ka statusin e magjistratit dhe kush nuk e ka statusin e magjistratit. Inspektorët magjistratë dhe jomagjistratë do të përcaktohen nga KLGJ mbështetur mbi të dhënat e paraqitura nga Kryeinspektori, Inspektori i KLD-së dhe KLD-ja; Kryeinspektori dhe inspektorët magjistratë do të konsiderohen si inspektorë në Zyrën e ILD-së në ditën e krijimit të ILD-së për një periudhë 6-mujore (neni 283, paragrafi 10, ligji për Qeverisjen).

Në fund të kësaj periudhe, ata kanë opsionet që vijojnë: Të qëndrojnë në detyrë në ILD nëse përmbushin kushtet dhe kriteret për inspektor; Të kthehen në pozicionin e mëparshëm nëse nuk përmbushin kushtet dhe kriteret për inspektor.

Konkluzionet në lidhje me statusin individual dhe karrierën e inspektorëve:

Të gjithë inspektorët janë ende nën procesin e “vetting”-ut; Inspektorët magjistratë që kanë punuar kryesisht për vlerësimin e performancës, duke përfshirë vlerësimin profesional komandohen në Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbajnë statusin e inspektorëve; deri sa të përfundojë mandati i tyre, siç përcaktohet me vendim të KLD-së. Në rast se mandati i tyre ka përfunduar përpara krijimit të KLGJ-së, ata kanë të drejtë të kthehen në pozicionin e tyre të mëparshëm ose të vazhdojnë të jenë inspektorë edhe për 6 muaj, ndërkohë që marrin pjesë në procedurat e ngritjes në detyrë dhe transferimit.

Kryeinspektori dhe inspektorët magjistratë që kanë punuar kryesisht për çështje disiplinore mbeten me statusin e inspektorit në KLGJ deri në krijimin e ILD-së; komandohen në ILD me krijimin e ILD-së për gjashtë muaj dhe më pas do të konfirmohen si inspektorë, nëse përmbushin kriteret për të qenë inspektorë, deri në fund të mandatit të tyre fillestar, siç përcaktohet me vendim të KLD-së ose PP-së. Brenda gjashtë muajsh kthehen në pozicionin e tyre të mëparshëm ose marrin pjesë në lëvizje paralele ose procedura ngritjeje në detyrë, nëse nuk përmbushin kriteret për të qenë inspektorë.

Inspektorët jomagjistratë, të pavarur nga çfarë janë caktuar të bëjnë kryesisht, – pasi ata nuk e shfrytëzuan mundësinë për të marrë pjesë në kursin dyvjeçar të trajnimit të kandidatëve magjistratë qëndrojnë në detyrë si “inspektorë” në KLGJ. Sapo konfirmohen me një vendim përfundimtar “vetting”-u, ata kanë të drejtë të caktohen në një pozicion nëpunësi civil gjyqësor ose një pozicion nëpunësi civil që përshtatet me profilin e tyre dhe për të cilin ata përmbushin kriteret. Në të njëjtën kohë, ata mund të marrin pjesën në procedurat e emërimit për çdo pozicion që përshtatet për profilet e tyre si jomagjistratë. Ekzistojnë argumente ligjore, në analogji me dispozitat për inspektorë magjistratë, për të konsideruar mandatet e tyre të përfunduara, në fund të mandatit, siç përcaktohet me vendim të KLD-së.

Legjislacioni i zbatueshëm: Neni 146/d (*në raport është shënuar neni 147/d*), paragrafi 1 e 2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i

Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Neni 179/9 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: Inspektori i Lartë i Drejtësisë emërohet brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mënyra e funksionimit të inspektorateve ekzistuese gjatë periudhës kalimtare rregullohet me ligj.

Neni E/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve në kohën kur kryhet rivlerësimi.

Neni 14 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon: Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbëhet nga Kryeinspektori dhe inspektorët. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit dhe numri i inspektorëve përcaktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë; Kryeinspektori dhe inspektorët emërohen dhe shkarkohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Zëvendëskryetarit; Kandidaturat e inspektorëve përzgjidhen, pas shpalljes publike, ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kushtet për t’u emëruar gjyqtarë në Gjykatat e Apelit dhe, në mungesë të tyre, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtarë jo më pak se 5 vjet; Veprimtaria e Inspektoratit drejtohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Kryeinspektori organizon dhe përgjigjet për veprimtarinë e përditshme të Inspektoratit; Për Kryeinspektorin dhe inspektorët, jo më pak se një herë në 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë; Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës. Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet nga Zëvendëskryetari për diskutim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 15 i ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon: Inspektorët emërohen në këtë detyrë për një afat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi; Periudha e ushtrimit të funksionit të inspektorit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale. Gjyqtarët, që shërbejnë si inspektorë në Inspektoratin e Këshillit të

Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë pa konkurs; Kryeinspektori përfiton pagë të njëjtë me Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, ndërsa inspektorët përfitojnë pagë të njëjtë me gjyqtarët e kësaj gjykate.

Neni 28 i ligjit 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcakton: Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës; Trajtimi financiar i gjyqtarëve gjatë kësaj periudhe bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave; Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale; Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4 i ligjit 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” parashikon se: “3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë; Pranimi dhe emërimi i gjyqtarëve a prokurorëve bëhet pasi të jetë dhënë pëlqimi, përkatësisht, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, sipas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë. Për vendet vakante në niveleve drejtuese dhe ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë, pranimi dhe emërimi bëhet pa konkurs; Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë; Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs.”

Neni 3/10 i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon: Organ i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i cili funksionon sipas ligjin 8811, datë 17.05.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Neni 278 paragrafi 1 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon: Nëpunësit civil dhe punonjësit e Këshillit të Lartë të Drejtësisë do të qëndrojnë në detyrë për një periudhë kalimtare deri në 6 muaj pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 283 paragrafi 9 e 10 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” parashikon: Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë pushon së zhvilluari veprimtaria e inspektimit pranë KLD-së. Në ditën e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Kryeinspektori dhe inspektorët, të cilët janë magjistratë konsiderohen pjesë e Zyrës së ILD për një periudhë 6-mujore.

Neni 160 paragrafi 1/c i ligjit 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon: Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektorët ekzistues do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme dhe të rregulluara dhe të parashikuara në ligj: c) vendos masa disiplinore, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, bazuar në procedurën dhe kriteret që parashikohen në pjesën V, kreu I, të këtij ligji.

Neni 168 paragrafi 1 i ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon: Inspektori dhe Kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ato i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 34/2017, ku ndër të tjera arsyetohet se: “Fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese, është vijimësia institucionale në ushtrimin e funksioneve për të garantuar vlerat dhe parimet, të cilat krijojnë bazën e shtetit të së drejtës. Ndryshimet kushtetuese të

datës 22 korrik 2016 përforcohen nga parimi i vijimësisë dhe koherencës institucionale, e cila garanton vlerat dhe parimet themelore të shtetit të së drejtës.

Konstatimet e Komisionit të Përkohshëm janë:

Pas përpunimit të të gjithë dokumentacionit që ndodhet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni i Përkohshëm konstaton se:

Inspektorja {...} ka lindur në Korçë me datë 10.03.1980. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1999-2003. Më pas ajo ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike 2003-2006. Zonja {...} është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me datë 06.11.2006 dhe ka punuar në këtë detyrë deri me datën 05.07.2013. Për këtë periudhë ajo ka pasur vlerësime profesionale për periudhat 2007-2009 dhe 2010-2012, duke u vlerësuar “Shumë mirë 3+” në të tre grup kriteret.

Me vendimin nr. 345, datë 05.07.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë zonja {...} është emëruar në detyrën e inspektore, ndërsa me datën 29.06.2018 i është zgjatur mandati deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke punuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, detyrë të cilën e ka kryer deri në muajin tetor të vitit 2017. Aktualisht kryen detyrën e Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë kryerjes së detyrës së inspektore, znj. {...} ka pasur vlerësime profesionale për periudhën 05.07.2013-31.12.2014, duke u vlerësuar “Shumë mirë 4+” në të katër grup kriteret.

Inspektorja {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim përpara Komisionit të Përkohshëm për të vazhduar punën në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke iu ruajtur statusin e magjistratit dhe paga e gjyqtarit të apelit. Asaj i ka mbaruar mandati 5-vjeçar i dhënë nga KLD, duke iu zgjatur ai deri në vitin 2018.

Znj. {...} ka punuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Inspektori {...} ka lindur në Gramsh më datë 15.05.1971. Është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1994-1998. Më pas ai ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike 1998-2001. Ai

është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd me 02.10.2001 dhe ka punuar në këtë detyrë deri me datë 17.12.2007. Në këtë periudhë ai ka pasur vlerësime profesionale për vitet 2005-2006, duke u vlerësuar “Shumë mirë 4+”, në të katër grup kriteret.

Me vendimin nr. 219, datë 17.12.2007 ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë e ka emëruar z. {...} inspektor pranë këtij Këshilli. Pas përfundimit të mandatit të parë si inspektor, ai ka marrë edhe një mandat të dytë, ndërsa me datën 24.01.2018 atij i është zgjatur mandati deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në bazë të Urdhrit nr. 08, datë 19.04.2013 të titullarit të ish-KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione, z. {...} është caktuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektorit/nëpunësit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë periudhës së punës si inspektor ka vlerësim për vitet 2013-2014, duke u vlerësuar “Shumë mirë 4+” në të katër grup kriteret.

Inspektori {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të vazhduar punën në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke iu ruajtur statusi i gjyqtarit të apelit, deri në emërimin si gjyqtar apeli.

Inspektori {...} ka lindur në Mirditë me datë 01.03.1955. Ai është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1993-1994.

Pas përfundimit të studimeve në drejtësi ai është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. 13, datë 24.11.1993 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa me vendimin nr. 5, datë 01.07.1994 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur vlerësime profesionale si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për vitet 2005-2006 dhe është vlerësuar “Shumë mirë 4+” në të katër grup kriteret, ndërsa për periudhën 2007-2009 është vlerësuar “Shumë mirë 3+” në të tre grup kriteret.

Me vendimin nr. 73, datë 10.07.2015 zoti {...} është emëruar në detyrën e inspektorit, duke mbuluar Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave. Nga muaji tetor i vitit 2017 kryen detyrën e Inspektorit/nëpunësit përgjegjës për vlerësimin

profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Inspektori {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të vijuar punën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ai është duke punuar brenda mandatit të dhënë nga KLD.

Gjatë periudhës së punës në inspektorat ai ka mbuluar Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektorit/nëpunësit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Inspektori {...} ka lindur në Gramsh me datë 01.01.1954. Është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1992-1994.

Pas përfundimit të studimeve për drejtësi është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh me vendimin e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 5, datë 01.07.1994, ndërsa me vendimin nr. 5, datë 06.07.1995 të po këtij Këshilli është emëruar gjyqtar po në këtë gjykatë. Më pas është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të suprimimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh me vendimin nr. 235, datë 24.10.2008 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me vendimin nr. 256/3/b, datë 15.06.2010 ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë, e ka emëruar z. {...} në detyrën e inspektorit dhe me vendimin nr. 64, datë 27.05.2016 të po këtij Këshilli ai ka marrë edhe një mandat të dytë si inspektor, pozicion të cilin e mban edhe aktualisht.

Në bazë të Urdhrit nr. 8, të vitit 2013 të titullarit të ish-KLD-së mbi ndarjen e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksione, z. {...} ka mbuluar Seksionin e Vlerësimit Etiko-Profesional, dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektorit/nëpunësit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë punës si inspektor ai është vlerësuar për periudhën 2013-2014 “Shumë mirë 3+” në tre grup kritere dhe “Mirë” në një grup kriter.

Inspektori {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të punuar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor derisa të ngrihet institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Inspektorja {...} ka lindur në Durrës me datë 28.03.2016 (*lapsus viti 2016, duhet 28.03.1963*). Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1993-1994.

Pas përfundimit të studimeve për drejtësi është emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me vendimin e ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 13, datë 24.11.1993 dhe më pas ajo transferohet po si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 01, datë 30.03.1995 të po këtij Këshilli. Më vonë është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 7, datë 08.02.1996 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Znj. {...} është shkarkuar nga detyra e gjyqtares, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 28/1, datë 20.03.1999 me motivacionin: “Për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”.

Gjatë viteve 1999-2003 ka punuar në profesionin e lirë të avokates, pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe më pas është emëruar si specialiste finance në Sektorin e Prokurimeve Publike, pranë Presidencës së Republikës së Shqipërisë.

Me vendimin nr. 312, datë 18.03.2013 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar në detyrën e inspektore, ndërsa me vendimin nr. 36, datë 07.05.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë asaj i është zgatur mandati i inspektorit deri në krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në bazë të Urdhrit nr. 8, datë 19.04.2013 të titullarit të KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit në seksione, znj. {...} ka mbuluar Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik, në procesin e shqyrtimit të vendimeve të cenuara nga gjykatat e niveleve më të larta dhe më pas me Urdhrin nr. 1, datë 07.01.2016 të ish-titullarit të këtij institucioni është caktuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave. Ndërsa prej muajit janar 2019 kryen detyrën e Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Ajo ka dhënë pëlqimin për të punuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Inspektorja {...} ka lindur në Dibër me datë 15.04.1958. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike ‘84-‘88. Pas përfundimit të studimeve në drejtësi ka punuar si Këshilltare ligjore, pranë Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Dibër. Me datë 01.07.1994 është emëruar në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 19.03.2003, kur është liruar nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj. Gjatë kësaj periudhe nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë vlerësim profesional.

Znj. {...} është emëruar inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë menjëherë pas lirimimit me dorëheqje nga detyra e gjyqtares, detyrë të cilën e ka mbajtur deri me datë 15.09.2010.

Me vendimin nr. 268, datë 15.09.2010 është emëruar në detyrën e inspektore, pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke u bazuar në ligjin 8811, datë 17.05.2001, ndërsa me datë 27.05.2016 ajo ka marrë edhe një mandat të dytë si inspektore, afat të cilin e përfundon në vitin 2021.

Në bazë të Urdhrit nr. 8, të vitit 2013 të titullarit të ish-KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit të Këshillit të Lartë në seksione, znj. {...} ka mbuluar Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Gjatë periudhës së punës si inspektore është vlerësuar për vitet 2013-2014 “Shumë mirë 3+” në tre grup kritere dhe “Mirë” në një grup kriter tjetër.

Inspektorja {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të punuar, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me status gjyqtari.

Inspektori {...} ka lindur në Korçë me datë 27.04.1969. Është diplomuar jurist në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike ‘87-‘91. Pas përfundimit të studimeve në drejtësi ka punuar si përmbartues gjyqësor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Më datë 20.10.1993 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 11.07.1998, ku me vendimin nr. 17 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është larguar nga detyra e gjyqtarit me motivacionin: “Për shkelje të rënda të disiplinës në punë”. Nuk rezulton që gjatë kësaj periudhe të ketë pasur ndonjë vlerësim profesional.

Gjatë periudhës 1998-2003 ka punuar në profesionin e lirë të avokatit, pranë Dhomës së Avokatisë Korçë. Më pas është emëruar në detyrën e avokatit të shtetit, pranë Zyrës Vendore Korçë, duke punuar në periudhën 2003-2009.

Me vendimin nr. 252, datë 22.09.2009 ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë, duke u bazuar në ligjin 8811, të vitit 2001 ka emëruar zotën {...} në detyrën e inspektorit, ndërsa me vendimin nr. 653, datë 27.05.2016 ai ka marrë edhe një mandat të dytë si inspektor,

Në bazë të Urdhrit nr. 8, 2013 të titullarit të ish-KLD-së mbi ndarjen e inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. {...} ka mbuluar Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave.

Nga muaji janar i vitit 2019 kryen detyrën e Inspektorit/nëpunësit përgjegjës për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Gjatë punës si inspektor është vlerësuar për periudhën 2013-2014 “Shumë mirë 1+” në një grup kriter dhe “Mirë” në tre grup kriter të tjera.

Inspektori {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të vazhduar punën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke e ruajtur statusin e gjyqtarit, sipas nenit 15 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001.

Inspektorja {...} ka lindur në Dibër me datë 07.11.1952. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike 1971-1975.

Pas përfundimit të studimeve në drejtësi ka punuar juriste në ish-Komitetin Ekzekutiv të Rrethit Dibër. Me datë 01.05.1983 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 1993, kohë kur është transferuar si hetuese në Rrethin e Kolonjës. Më pas znj. {...} ka dhënë dorëheqjen nga detyra e hetueses dhe ka ushtruar profesionin e lirë të avokatit gjatë periudhës 1993-2010.

Me vendimin nr. 270, datë 12.11.2010 ish-Këshilli i Lartë të Drejtësisë, duke u bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” ka emëruar znj. {...} në detyrën e inspektores, pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa në bazë të Urdhrit nr. 8, të vitit 2013 të titullarit mbi ndarjen në seksione, ajo ka mbuluar Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave, ndërsa me një urdhër tjetër të mëvonshëm dhe me nr. 01 të vitit 2016 ajo ka mbuluar Seksionin e Vlerësimit Profesional dhe Etik. Zonja {...} me vendimin 66, datë 27.05.2016 ka marrë edhe një mandat të dytë si inspektore dhe që prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e

Inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Gjatë punës si inspektore ajo është vlerësuar për periudhën 2013-2014 “Shumë mirë 3+” në tre grup kritere dhe “Mirë” në një grup kriter.

Inspektorja {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të vazhduar punën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Inspektorja {...} ka lindur në Gramsh me datë 21.10.1968. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitet akademike ‘87-‘91. Pas përfundimit të studimeve në drejtësi është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 13.05.2000 kur me vendimin nr. 83 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo lirohet nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj.

Nuk rezulton që gjatë kësaj periudhe të ketë pasur ndonjë vlerësim profesional.

Me datë 15.05.2000 është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 01.01.2011 (*në raport është shkruar 01.03.2011*). Më pas me datë 04.01.2012 emërohet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë si specialiste në Drejtorinë Juridike.

Me vendimin nr. 129, datë 18.11.2016 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ajo është emëruar inspektore pranë Inspektoratit të këtij Këshilli, duke u marrë me Vlerësimin Etiko-Profesional të gjyqtarëve, ku ka zëvendësuar edhe ish-inspektoren Vojsava Osmanaj, e cila është rikthyer në sistemin gjyqësor. Ndërsa prej muajit tetor të vitit 2017 kryen detyrën e inspektore/nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Inspektorja {...} ka dhënë pëlqimin me shkrim për të vazhduar punën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me status gjyqtari duke u bazuar në nenin 28 të ligjit 9877/2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” dhe nenit 4, të ligjit nr. 8678/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

Kryeinspektorja {...} ka lindur në Berat me datë 06.03.1975. Është diplomuar juriste në Fakultetin e Drejtësisë në vitet akademike ‘93-‘97. Më pas ajo ka përfunduar edhe Shkollën e Magjistraturës në vitet akademike 1997-2000.

Pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me Dekretin nr. 2756, datë 27.09.2000 të Presidentit të

Republikës së Shqipërisë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri kur me vendimin nr. 219, datë 17.12.2007 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë largohet nga sistemi gjyqësor për të shërbyer në nivele drejtuese në Ministrinë e Drejtësisë.

Duke u bazuar në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 303, datë 18.01.2013 e ka emëruar znj. {...} në detyrën e {...} të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, detyrë të cilën e kryen edhe aktualisht.

Gjatë periudhës si {...} është vlerësuar “Shumë mirë 4+” në katër grup kriteret për vitet 2013-2014.

{...} ka deklaruar se i përfundon mandati i {...} në momentin që krijohet Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Me vendimin nr.115, datë 11.03.2019 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit për znj. {...} pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur me arsyetimin se subjekti e ka humbur statusin e magjistratit dhe për pasojë duhej të testohet nga Shkolla e Magjistraturës, si pjesë e procesit të rivlerësimit. Kjo procedurë nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit dhe është konstatuar se subjekti nuk i është nënshtruar testimit nga Shkolla e Magjistraturës.

Konkluzionet e Komisionit:

Në nenin 3/10 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar se: Organ i vlerësimit të aftësive profesionale është Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili funksionon sipas ligjin nr. 8811, datë 17.05.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Që nga fillimi i procesit të rivlerësimit në muajin tetor 2017, inspektorët kanë përfunduar gjithsej 164 relacione për vlerësimin profesional të gjyqtarëve në zbatim të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” nga 465 subjekte të rivlerësimit që kanë dorëzuar dokumentet, pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjë që tregon se pjesa më e madhe volumit të punës në këtë drejtim është e pakryer.

Në strukturën e re që ka miratuar Këshilli i Lartë Gjyqësor bën pjesë edhe Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik e Gjyqtarëve me përbërje 6+1 (*në raport është shkruar 5+1*), detyrë të cilën nga tetori 2017 inspektorët që kanë punuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke krijuar një përvojë të admirueshme në këtë drejtim, siç e tregojnë edhe rezultatet e vlerësimeve, të cilat janë pasqyruar më sipër dhe relacionet që janë dorëzuar, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në zbatim të kësaj dispozite ligjore del e qartë se, ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij që ky vlerësim profesional do të kryhet vetëm nga kjo strukturë e specializuar në vite, pikërisht në vlerësimin dhe kontrollin e gjyqtarëve.

Në përmbushje të detyrave të caktuara nga KLD-ja kanë punuar në Seksionin e Inspektimit dhe Verifikimit të Ankesave deri në vitin 2017 inspektorët: {...}, {...}, {...}, {...} dhe {...}. Këto inspektorë janë vlerësuar “Mirë” dhe “Shumë mirë” për performancën. Pas tetorit të vitit 2017 pjesa më e madhe e inspektorëve (me përjashtim të inspektorëve {...} dhe {...}) kanë punuar për vlerësimin profesional të gjyqtarëve për llogari të organeve të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kanë përmbushur detyrat e caktuara nga KLD-ja në Seksionin e Vlerësimit Etiko-Profesional të gjyqtarëve, inspektorët {...}, {...}, {...}, {...}. Edhe ky grup inspektorësh është vlerësuar “Mirë” dhe “Shumë mirë” për performancën e tyre, duke qenë mjaft të dobishëm për mbarëvajtjen e punëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor sidomos në këtë periudhë tranzitore.

Në këto kushte, Komisioni i Përkohshëm i Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i rekomandon Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Inspektorët {...}, {...}, {...} dhe {...}, të cilët kanë ardhur si inspektor në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë direkt nga gjykatat e rretheve gjyqësore Gjirokastrë, Librazhd, Durrës dhe Elbasan e kanë ruajtur statusin e gjyqtarit, prandaj duhet konfirmuar për to statusi i magjistratit.

Për inspektorët {...}, {...} dhe {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të ketë parasysh edhe zbatimin e ligjit nr. 96/2016 për Statusin, pasi ato e kanë mbushur një mandat 5-vjeçar dhe nuk mund të punojnë dy mandate rresht në Këshill dhe njëri nga këta ka mbaruar edhe mandatin 10-vjeçar, i cili është {...}.

Për sa i përket katër inspektorëve të mësipërm, Komisioni i Përkohshëm ka patur një qëndrim unanim, ndërsa për sa u takon inspektorëve të ardhur si jurist, përfshi këtu dhe {...} qëndrimet e anëtarëve të Komisionit nuk kanë qenë të njëjta, prandaj Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi të diskutojë nëse mund të shqyrtohet statusi i inspektoreve {...} nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, përpara se të shprehet Komisioni i Pavarur i Apelit, për ankimin e bërë prej saj kundër vendimit nr. 115, datë 11.03.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe nëse ka lidhje ky fakt me inspektorët e tjerë juristë, të cilët kanë dorëzuar edhe ato dokumentet, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet të shprehet për variantet e mëposhtme:

Varianti 1: Inspektorët {...}, {...}, {...}, {...} të cilët nuk kanë ardhur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë direkt nga sistemi i drejtësisë nuk e kanë statusin e gjyqtarit, prandaj nuk u duhet konfirmuar statusi i magjistratit.

Duke u bazuar në nenin 165/4 të ligjit nr. 96/2016, ato duhet t'i nënshtrohet një testimi profesional në Shkollën e Magjistraturës dhe pas kalimit me sukses të tij të ndjekin 1 vit program trajnimi në Shkollën e Magjistraturës dhe 1 vit praktikë profesionale, duke u bazuar në nenin 165/9 të ligjit nr. 96/2016, t'u propozohet për t'u emëruar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor ose nëpunës civilë në sistemin e prokurorisë nëse kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndërsa për inspektorët {...} dhe {...}, bazuar në nenin 160/ë të ligjit nr. 96/2016, Këshilli duhet të përgatisë vendimin për mbarimin e mandatit si inspektor, pasi konstaton se ato kanë mbushur moshën për pension.

Varianti 2: Inspektorët {...} dhe {...} që kanë ardhur në punë si inspektore nga Ministria e Drejtësisë dhe Gjykata e Lartë, pa shkëputje, gëzojnë statusin e gjyqtarit, sepse kanë punuar vazhdimisht në funksione/institucione që e kanë gëzuar këtë status. Kryeinspektorja {...}, për të njëjtat arsye si inspektorët {...}, etj. e gëzon statusin e gjyqtarit, prandaj për këto duhet të konfirmohet statusi i magjistratit. Ndërsa inspektorët {...}, {...} dhe {...} që kanë ardhur në Inspektoratin e ish-KLD-së nga juristët që kanë punuar jo me pak se 5 vjet gjyqtar nuk gëzojnë statusin e gjyqtarit dhe për to nuk duhet të konfirmohet statusi i magjistratit. Ato mund të vazhdojnë punën si inspektor me statusin e nëpunësit civil.

Varianti 3: Inspektorët {...}, {...} dhe Kryeinspektorja {...} e kanë rifituar statusin e magjistratit në bazë të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” i cili është edhe ligji i posaçëm që rregullon këtë fushë dhe jo duke u bazuar në nenin 28 të ligjit 98/2017 (*lapsus, pasi duhet ligji 9877*), datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 4 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, siç thuhet në variantin nr. 2. Për të njëjtin shkak këtë status e kanë fituar edhe inspektorët {...}, {...}, {...}, prandaj atyre duhet tu konfirmohet statusi i magjistratit.

Komisioni i Përkohshëm për vlerësimin e statusit individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Mendimi që ka edhe shumicë, i Këshillit, është që, para se të procedojmë për secilin inspektor, Këshilli duhet të shprehet që a mund të vazhdojmë procedimin për {...} si dhe për inspektorët e tjerë, pasi ato janë subjekte rivlerësimi dhe për këtë është mbajtur një qëndrim nga KPK-ja dhe çështja është në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Këto kisha për të thënë.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zoti Bici për raportin shumë të detajuar, sqarues dhe ezaurues.

Atëherë, kalojmë në diskutimin e raportit.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, në diskutimin që do mbaj, do të jem shumë konciz.

Referuar raportit të mbajtur nga Komisioni i Përkohshëm, duket që për katër nga inspektorët, të tre anëtarët e Komisionit ndajnë të njëjtën pikëpamje për pasjen e statusit nga ana e tyre, ndërkohë për gjashtë të tjerët, Komisioni ndan pikëpamje të ndryshme.

Në fakt ajo që unë i propozoj Këshillit është që të vijojë me procesin për sa i përket katër inspektorëve {...}, {...}, {...} dhe {...}, ndërkohë që për 6 inspektorët e tjerë, ku nga ana e Komisionit u konsiderua që Këshilli paraprakisht të vendosë nëse do duhet ta vazhdojë apo jo procesin për shkak të një vendimmarrjeje që pritet në Komisionin e Posaçëm të Apelit, mendoj që ta shtyjmë për mbledhjen e radhës. Kjo edhe për të na dhënë pak mundësi për t’u përgatitur, referuar faktit se për rrethana të ndryshme që kanë inspektorët mes tyre, por për më tepër për faktin që legjislacioni ndër vite ka pësuar

shumë ndryshime dhe do duhet të rikonsiderojmë të gjithë këto për secilin nga inspektorët.

Unë personalisht, për momentin, nuk jam gati që të shpreh votën time për secilin nga gjashtë inspektorët e tjerë. Pra propozimi im konkret është që të vijojë procesi për katër inspektorët si më lart. Mbase për inspektorin {...}, Komisioni do duhet të konsiderojë edhe një rrethanë të re fakti. Ky inspektor, siç referohet në relacionin e përgatitura, ka mbushur moshën 65 vjeç, që është konsideruar si mosha e pensionit në janar të vitit 2019. Gjithsesi ai ka vijuar të ushtrojë detyrën pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërkohë që në korrik të vitit 2019, ligji për Statusin ka ndryshuar dhe është përcaktuar që mosha e mbarimit të statusit është 67 vjeç. Mbase Komisioni duhet ta përditësojë këtë fakt dhe të na shprehë opinionin e tij nëse vijon të ketë statusin apo është para kushtit të mbarimit të statusit inspektori {...} (aktualisht nëpunës vlerësues). Pra këto ishin propozimet. I bie që praktikisht të vijojmë procesin për tre..., inspektorin {...}, Komisioni të rikonsiderojë përditësimin edhe për këtë rrethanën e re të faktit, ndërkohë që për gjashtë të tjerët të vijojmë shqyrtimin në mbledhjen e radhës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga zoti Toska lidhur me mënyrën se çfarë do shqyrtojmë sot në këtë mbledhje, nëse do i shqyrtojmë të gjithë inspektorët e ish-KLD-së apo do shqyrtojmë vetëm tre prej tyre, që konkretisht janë {...}, {...} dhe {...}.

Po! Përpara se ta kalojmë për votim, zoti Bici!

Medi Bici: Kisha vetëm për {...}n.

Për {...}n e ezauruam, e thamë.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë propozimin për votim.

Jemi dakord që të diskutojmë sot vetëm tre nga dhjetë inspektorët dhe për t'i shtyrë në mbledhjen e radhës, pra mbledhjen tjetër do diskutohen shtatë të tjerët.

Maksim Qoku: Vetëm një sqarim.

Ideja është që, do t'i jepet Komisionit përsëri e drejtë që të vazhdojë t'i përpunojë? Pra do kalojë prapë tek neve?

Ilir Toska: Vetëm për inspektorin {...}, të reflektohet kjo ecuria..

Maksim Qoku: Vetëm Fatbardhi? Okej!

Por në fakt unë pranoj edhe një gabim që ka bërë Komisioni, tani tek shihja letrat e konstatova. Neve formalisht nuk kemi bërë kërkesën për verifikimin e diplomave sepse qenia si pedagog – pashë një dokument që nuk është se është i fakultetit tonë – që formalisht duhet ta kishim bërë, të konfirmohet që është diploma, s’është diploma. Të paktën formalisht ta bëjmë se është detyrim ajo, kur bie një dokument zyrtar, sidomos diplomë, i bëhet kërkesë sekretarisë përkatëse dhe ai bie një konfirmim.

Ilir Toska: Unë shpreha qëndrimin tim rreth asaj që kisha të nevojshme. Nëse ju si Komision keni nevojë për një gjë tjetër, është një çështje që mund ta konsideroni ta bëni ju.

Brikena Ukperaj: Edhe diçka tjetër kisha.

Në fakt, kisha dy propozime.

Referuar relacionit, qëndrimi i të gjithë inspektorëve kishte qenë i ndryshëm. Disa shpreheshin që do të vazhdojmë të punojmë në Këshill; disa shprehnin vullnetin që do të punojmë këtu derisa të krijohet ILD-ja; dhe është e mira që të gjitha këto dokumente, se ndoshta nuk i keni pasqyruar me saktësi, t’i kemi në dispozicion. Nga materiali, nuk i kemi të printuar të gjithë shfaqjen e vullnetit që ka bërë gjithsecili nga inspektorët, sepse janë të rëndësishëm. Për shembull, zonja {...}, në relacion thuhet që do vazhdojë të punojë në Këshill me statusin e gjyqtarit të apelit edhe pagën, por nuk shprehet gjë që do vazhdojë këtu dhe nuk do të shkojë tek ILD-ja, apo do vazhdojë derisa të shkojë tek ILD-ja, -se janë elementë të rëndësishëm. Dhe e dyta, nga dosjet personale të secilit inspektor rezulton që janë pjesë vetëm vendimmarrjet e Këshillit, por nuk janë pjesë dokumentacioni apo kërkesat që ata kanë bërë në Këshill. Ka vendime të rizgjatjes së mandateve apo të mbarimit të pozicionit të inspektorit në Ministrinë e Drejtësisë dhe emërimit si inspektor këtu, por nuk ka vetë inspektorët se si e kanë trajtuar statusin e tyre dhe si i janë drejtuar Këshillit. Nuk e di nëse është e mundur që në arkivën e Këshillit të ndodhen gjithë këto kërkesat që ata janë drejtuar sepse në dosjet personale të tyre ishin vetëm pjesa e vendimeve. Për shembull, thuhet në vendim “Pranojmë kërkesën për heqje dorë nga detyra e gjyqtarit”. Tani, na duhet edhe kjo kërkesa për të parë. Heq dorë nga statusi apo heq dorë nga një detyrë për të marrë një detyrë dhe të ruajë statusin. Për këto arsye mendoj që është e nevojshme ose të paktën një relacion, këto vendimmarrjet e

KLD-së nuk kanë patur një relacion bashkëngjitur sepse unë mendoj që është e rëndësishme, pastaj si ta vlerësoni.

Naureda Llagami: Atëherë, nëse ne biem dakord këtu të kalojmë në votim propozimin që bëri Iliri lidhur me çfarë do marrim sot në shqyrtim, do marrim tre nga dhjetë. Pa diskutim që pjesa tjetër, ju mund të lini detyra Komisionit ta diskutojmë, për të verifikuar dhe për ta thelluar verifikimin e gjendjes së faktit që ka situata e secilit prej inspektorëve. Kështu që kjo është pjesë tjetër.

Diskutimi parimor që kemi këtu është që unë personalisht në cilësinë e Kryetares e kam prioritarë që ne duhet ta kishim marrë këtë vendimmarrje shumë kohë më parë. Në eventualitetin që struktura është përfunduar në korrik, ishte detyra jonë që neve në korrik të shpreheshim lidhur me statusin, për t'i konfirmuar edhe pozicionet përkatëse. Kështu, çdo zvarritje e këtij procesi, është një kosto për institucionin, prandaj kërkoj nga ana juaj bashkëpunimin për të marrë një vendim sa më parë. Administratën e keni në dispozicion për të reaguar lidhur me këtë situatë. Kështu që, në mbledhjen tjetër të Këshillit, që i bie të jetë javës tjetër, unë patjetër dua që nga ana e Këshillit të merret një vendimmarrje definitive lidhur me statusin e inspektorëve.

Atëherë, po kaloj në votim propozimin e bërë nga...

Brunilda Kadi: Një sekondë, mund të them diçka?

Ajo që propozoi zonja Ukperaj dhe zoti Qoku, janë shtyrje për të gjithë, se ne nuk mund të votojmë atë që propozoi zoti Toska, në qoftë se themi që do marrim dokumente shtesë, -se nuk ka sens kjo. Për shembull, për zonjën {...} ose disa të tjerë që përmendi zonja Ukperaj, që duhet parë dokumentacioni, se janë të mangëta dokumentacionet, për shembull, nuk kemi kërkesat për heqje dorë - atë që u përmend – nga statusi, nga detyra e gjyqtarit. Nuk kemi deklarin e pëlqimit ku duan të shkojmë, apo atë që përmendi zoti Qoku për pjesën e verifikimit të diplomave, se në qoftë se do verifikohen, do verifikohen për të dhjetë. Formalisht, jo formalisht, nuk mund të diskriminohet. Kështu që mendoj që duhet të biem dakord njëherë për këto që u propozuan, pastaj të hidhet në votim ajo që tha Iliri. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, nga Komisioni, keni ndonjë sqarim lidhur me çështjet që u ngritën, që ngriti Brikena për sa i përket... se një nga detyrat që ka patur Komisioni,

ka marrë shprehjen e vullnetit të secilit inspektor për të vazhduar marrëdhënien pranë Këshillit.

Fatmira Luli: Janë marrë.

Naureda Llagami: Janë marrë.

Atëherë, në qoftë se janë të marra dhe i keni të administruara në dosje, ka mundësi të na i vendosni një kopje?

Fatmira Luli: Ne i kemi marrë si deklarata, të të gjithëve. E kanë shprehur të tërë pëlqimin për të vazhduar punë.

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Unë desha të diskutoj lidhur me {...}n e cila s'duhet të jetë objekt i shqyrtimit edhe në mbledhjen e ardhshme, për shkak të pozitës së posaçme që ka si Kryeinspektore, pavarësisht vendimit tonë, ajo duhet të jetë prezent në detyrën e Kryeinspektorit deri në krijimin e ILD-së. Këtë detyrë ia ngarkon ligji. Kështu që, po të lexosh edhe detyrat e vendimit dhe vendimin e Komisionit të Përkohshëm, bën fjalë vetëm për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky Komision nuk e ka në misionin e tij të hetojë dhe t'i përcaktojë statusin Kryeinspektorit sepse s'është pjesë e vendimmarrjes dhe detyrave që ka lënë Komisioni i Përkohshëm dhe mbledhja plenare për krijimin e këtij Komisioni. Kështu që propozoj që mos të jetë objekt shqyrtimi nga ky Komision dhe propozimesh për Kryeinspektoren.

Ajo të mos shqyrtohet. Të shtyhet vetëm për inspektorët e tjerë. Për {...} të mos shqyrtojë fare Komisioni asnjë akt për shkak se nuk është në objektin e Komisionit shqyrtimi i pozitës dhe statusit të Kryeinspektorit.

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë për të qartësuar diskutimet.

Diskutimi i parë ishte që, nëse neve do i mernim të gjithë për shqyrtim, propozimi ishte të mos merren të gjithë për shqyrtim.

Propozimi tjetër ishte që, për shkak se raporti ka mangësi në dokumentacion dhe në verifikimin e kushteve, kërkohet kohë për të bërë plotësim të raportit. Dhe unë dua një sqarim nga ana e Komisionit, për të gjithë kohën e nevojshme që keni pasur për të hartuar këtë lloj raporti, sa kohë doni për të sqaruar, për të plotësuar raportin sipas kërkesave që bëjnë anëtarët këtu. A keni më nevojë që ta plotësoni raportin? – ngrihet çështja.

Po ose jo!

Këtë kalojmë për votim.

Nëse nuk keni nevojë, atëherë kalojmë për votim sipas propozimit që ka bërë zoti Toska dhe më pas hedhim propozimin tuaj Fatmira.

Fatmira Luli: Raporti përmban të gjithë dokumentacionin dhe raporti është i plotë. S'ka asnjë dokumentacion. Ai dokumentacion ekziston. Është gabim i administratës që s'i ka bashkuar bashkë, që s'i ka futur materialet. Të tërë deklaratimet ndodhen në dosjen personale të inspektorëve. Janë marrë.

Naureda Llagami: Shumë mirë.

Administratën e kemi prezent këtu.

Vildan, të lutem, të gjithë dosjet dhe të gjithë deklaratimet këtu.

Maksim Qoku: Që të mos ngatërrohem.

Ideja e të kërkuarit formal për verifikimin e diplomave, okej, duhej të ishte bërë kam përshtypjen sepse e kërkon procedura. Por vetë raporti është i plotë. Nuk ka çfarë shtohet sepse ne kemi disponuar mbi të gjithë materialet. Pra materialet nuk janë shoqëruese të raportit por ne i kemi parë, i kemi trajtuar dhe i kemi referuar, ne si Komision, s'kemi çfarë i bëjmë raportit më. Për faktin tjetër të atij verifikimit, okej. Prandaj e pyeta Ilirin a kemi ne të drejtë si Komision që të bëjmë këtë gjë? - dhe kjo bëhet shpejt. Pjesët e tjera të dokumentacionit janë. Administrata jua vë në dispozicion, siç i kemi pasur ne.

Ilir Toska: Atëherë, propozimi im i parë kishte të bënte, që të vijojmë me procedurat për tre nga inspektorët. Kam përshtypjen që asnjëri nuk ka ndonjë vërejtje apo kërkon ndonjë material shtesë për tre inspektorët. Mund të procedojmë për të tre dhe për të gjithë të tjerët, qoftë na duhet dokument për ta parë, qoftë për t'u vlerësuar edhe një herë të gjithë faktet dhe ligjin, unë dhashë propozimin që ta shtyjmë. Se sa kohë të vazhdojmë që të sjellë administrata njëherë të gjithë letrat... kam përshtypjen që kërkesa e zonjës Ukperaj lidhej me të gjithë këta që unë bëra propozimin që të shtyhej. Apo jo?

Brikena Ukperaj: Për sa i përket plotësimit të dokumentacionit me letërkëmbimet ose korrespondencën që ka patur me Këshillin, lidhet me të tjerët, por për sa i përket shfaqjes së vullnetit nga tre gjyqtarët {...}, {...} dhe {...}, është i rëndësishëm sepse referuar relacionit, rezulton që këta kanë dhënë pëlqim për të punuar në Këshillin e Lartë Gjyqësor duke ruajtur statusin e magjistratit dhe pagën e gjyqtarit të apelit. Kaq.

Medi Bici: ...derisa të shkoj gjyqtar, -thotë {...}.

Brikena Ukperaj: Po nuk e ke në relacion, prandaj po them. Prandaj të pyeta.

Sepse, fakti nëse duan të shkojnë tek ILD-ja...

Medi Bici: Qëndrimi që mban zoti Ilir është i drejtë. Arsyeja që të tre këto gjyqtarë, sido që të jenë, nuk mund të rrinë më. Ne do të përgatisim procedurat që ato të shkojnë gjyqtarë. Ne do të shprehemi sot vetëm për konfirmimin e statusit. Prandaj, ne të vazhdojmë, mos t'i pengojmë. Për të tjerët pastaj i verifikojmë të gjitha, për gjyqtarët që kanë ardhur nga gjykatat e rretheve sepse njëri ka mbushur mandatin dyvjeçar dhe nuk mund të rrijë më në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duhet të shkojë gjyqtar, {...}. Zonja {...} ka mbushur mandatin 5-vjeçar dhe nuk mund të rrijë dy mandate rresht pa shkuar të bëjë 5 vjet punë në gjykatë të rrethit.

Nuk do shprehemi sot pra. Ne do shprehemi sot vetëm për statusin. Kështu që nuk ka rëndësi pëlqimi i atyre. Ato kanë thënë përkohësisht do rrinë këtu. Mund të shkojnë në ILD. Në të njëjtën pozitë është edhe tjetri sepse ka dy mandate. Vetëm {...} deri në shkurt ka mandat, se {...}n e përjashtuam.

...verifikimin e diplomave. Ne s'po bëjmë emërime të reja ose lëvizje. Ne po shikojmë. Ata kanë 20 vjet në punë.

Marçela Shehu: Kisha një pyetje për zotin Maksi.

A ka ndonjë të dhënë konkrete që ju bën juve, ju çon juve drejt kërkesës tuaj për të bërë një verifikim të diplomave apo jo?

Maksim Qoku: Është një gjë interesante sepse jam i kohës. Diplomat e asaj që ne i thoshim kurs, kanë pasur një shënim “kurs i plotë i përsheptuar” dhe diploma që kam tek njëri prej personat nuk e ka këtë të shënuar. Në këqyrje të firmave që unë kam qenë bashkëkohës i atyre, ndjesë pastë, gjysma kanë vdekur, nuk shoh që të jenë ato firma, gjë që unë s'jam ekspert se sy është. Dhe në këqyrje të procesverbalit të notave, diku ka 28 lëndë, diku ka 30. Çka do të thotë më lindi ideja e verifikimit sepse janë disa gjëra që harrohen-harrohen por formalisht ne e kemi detyrim se e kemi detyrim se jemi Komision dhe duhet ta nisim nga A-ja.

Brunilda Kadi: Po kur të krahasohen të dyja, ku e di ti kush cila nga ato është origjinalja.

Maksim Qoku: Pikërisht pra, prandaj thashë. E kërkoj për të gjithë, për të gjitha pra konfirmim, se është A-ja, tek ne ka qenë A-ja.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Edhe ajo tjetra futet tek ajo treshja që doni të kaloni.

Maksim Qoku: Këtë po them unë, këtë Komisioni e ka mangësi, qoftë edhe formalisht. Ajo bëhet brenda ditës. Duhet ta kishim bërë.

Brunilda Kadi: Më fal! Në momentin kur vetë anëtari i Komisionit deklaroi që është mangësi, unë nuk e di se si...

Maksim Qoku: Mirë pra, vetëm këtë s'e kemi bërë. Mirë të ishte bërë.

Brunilda Kadi: Mirë pra, se s'është gjë e vogël ajo. Edhe vetë e vlerëson Komisioni që duhet bërë. Tani, në qoftë se e shtyjmë 1 javë për të gjithë... Unë nuk e kuptoj, se përderisa u shty 9 muaj kjo histori, se u shty edhe 1 javë, nuk besoj se ka ndonjë pasojë juridike, kur vetë e deklaroni si Komision që...

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Por s'është për treshen për të cilën...

Brunilda Kadi: Është pra për treshen, sepse ato që po përmend zoti Maksim, njëri prej atyre është tek treshja. Po, është tek treshja, dhe ti nuk...

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Është pra është. Mira, sapo e tha Maksim. Njëra është e treshes, tjetra është jashtë treshes. Si do ta verifikosh ti se cila nga këto është. Ne prezumojmë që ato janë origjinale të dyja.

Maksim Qoku: Mund të jenë të dyja, por do e marrim vesh.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë çështjen e parë për votim.

A duhet Komisioni të rishikojë edhe një herë raportin për të verifikuar, sipas propozimit të bërë nga anëtari i Komisionit, zoti Qoku?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

(Vota e zotit Medi Bici nuk dëgjohet.)

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, për të vijuar më tej, unë kërkoj që të lejmë edhe një afat të arsyeshëm për ju për të bërë verifikimin e pretendimeve dhe dyshimeve që mund të keni lidhur me materialet e administruara në dosje. Ndërkohë, duhet të mbani parasysh dhe sugjerimet e bëra nga zonja Ukperaj, së bashku me stafin, për të pasqyruar në dosje të gjithë dokumentacionin e administruar për efekt të këtij procesi.

Atëherë, sa mendoni që ju duhet një afat i arsyeshëm?

Po pyes vetë anëtarët e Komisionit për këtë pjesë.

Atëherë, me propozim të Komisionit, kërkohet 1 javë kohë për ta rishikuar dhe verifikuar edhe një herë raportin, me qëllim që neve më pas të kalojmë në pjesën e vendimmarrjes së statusit për secilin nga inspektorët.

Ndërkohë, unë do ju bëja me dije që edhe për pjesën tjetër, për pjesën pas verifikimit, por edhe lidhur me vlerësimin e statusit, Komisioni të bashkëpunojë me anëtarët, për të arritur në një qasje, që ne javën tjetër më pas, kur kjo të përfshihet në rendin e ditës, të kemi një vendimmarrje finale/përfundimtare.

Atëherë, shtyhet kjo çështje e rendit të ditës për javën tjetër, për javën pasardhëse.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 26.09.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e z. {...} nga procedurat e komandimit, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:07 dhe mbaroi në orën 14:57.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Brunilda Kadi* (anëtare)
5. *Fatmira Luli* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ilir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 6. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 7. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 8. Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
- 9. Edlira Bako, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 10. Arlind Maloku, Qendra Evropiane.*
- 11. Charles Ericksen, USAID.*
- 12. Valbona Bala (Pajo), USAID.*
- 13. Julinda Beqiraj, EURALIUS.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përjashtimin e z. {...} nga procedurat e komandimit, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës”, i përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e katërt e rendit të ditës.

E cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për dërgimin e emrave të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar në pozicionin e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës. Ky lloj projekt-akti është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Marçela Shehu: Po! Faleminderit Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 264 dhe 265 të ligjit 115/2016, bazuar në nenet 53 e 54 të ligjit nr. 96/2016 për Statusin, mbi kërkesën e Shkollës së

Magjistraturës, me vendimin nr.133, datë 09.07.2019, shpalli rihapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t'u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Ky vendim është shpallur në faqen zyrtare të internetit më datë 10.07.2019. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 3 (tre) javë nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave, pra brenda datës 31.07.2019, pranë Këshillit ka paraqitur kërkesë z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 4, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2016 për Statusin lidhur me vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar se në rastin konkret, komandimi i këtij gjyqtari vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ai ushtron funksionin.

Në dhënien e këtij vlerësimi, Komisioni konsideron faktin që Gjykata e Apelit Shkodër, në organikën e saj, ka 10 gjyqtarë dhe aktualisht këtë funksion e ushtrojnë 8 gjyqtarë, për shkak se gjyqtarët {...} dhe {...}, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Gjithashtu Këshilli ia vlerësuar edhe ngarkesën e kësaj gjykate, ku nga komunikimi që kemi pasur me administratën e gjykatës ka rezultuar se kjo gjykatë aktualisht ka në gjykim 1391, nga ku rezulton që mesatarja e çështjeve në gjykim për gjyqtar si relator të jetë 173.

Bazuar në sa më sipër, duke konsideruar se Gjykata e Apelit Shkodër ka një organikë jo të plotë aktualisht, pra nga numri 10 i organikës, funksionon me 8 gjyqtarë për shkak të shkarkimit të 2 gjyqtarëve; Faktin që gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate janë në proces rivlerësimi, rezultatet e të cilit nuk mund të parashikohen; Faktin që nga të dhënat që kemi, ne kemi konkluduar që ngarkesa e kësaj gjykate është e lartë, pra thamë 173 çështje për gjyqtar, duke përfshirë këtu vetëm çështjet ku ata janë caktuar si relatorë; Faktin që gjykata e apelit gjykon me trup gjykues me 3 gjyqtarë dhe largimi i një gjyqtari nga trupi gjykues cenon funksionimin dhe mbarëvajtjen normale të të gjithë gjykatës; Komisioni vlerëson se, komandimi i z. {...}, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në

Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, cenon interesat e larta të kësaj gjykate për shkak se cenohet funksionaliteti i saj, bazuar në shkaqet e cituara në këtë relacion.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor: Përrjashtimin e z. {...} nga procedurat e komandimit, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Shehu.

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës para se ta hedhim për votim?

Jo!

Atëherë, kalojmë për votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi të përjashtojë kandidatin {...}, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga procedurat e komandimit në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, për shkak se cenohet funksionaliteti i gjykatës në të cilën ushtron detyrën. 2. Publikimin e opinionit “Mbi kandidatin që ka aplikuar për t’u komanduar si pedagog i brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës” në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e këtij projekt-akti, Këshilli përfundon edhe mbledhjen për sot.

Përpara se ta përfundojmë mbledhjen, kam tre çështje prioritare që unë dua t'ju sjell në vëmendje për javës tjetër.

Së pari, dua që për javën tjetër neve të ndërmarrim situatën për magistratët, për kandidatët për magistratë, për të cilët unë kërkoj nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës të hartojë relacionet, për ato të paktën për të cilët ka përfunduar procesi i verifikimit të asetëve dhe figurës, të kalohen në rendin e ditës. Të mbarohen sa më shpejt sepse është e pritshme që në tetor, siç e dini, fillon viti shkollor.

Ndërkohë, prioritet tjetër, ka të bëjë lidhur me Komisionin e Vlerësimit të Etikës. Siç jeni në dijeni, pjesa e vlerësimit të etikës është një pjesë që neve na kushtëzon në hartimin e Rregullores për Vlerësimin, është një pjesë që na kushtëzon në emërimin e kandidatëve magistratë, si gjyqtarë. Kështu që, ju bëj me dije që duhet patjetër që kjo lloj rregulloreje të kalojë dhe të përfundojë sa më parë të jetë e mundur. Unë nuk e di në çfarë stadi është rregullorja, por është e nevojshme që brenda javës së parë të tetorit ne të kemi një draft rregullore që ta diskutojmë.

Ndonjë gjë tjetër lidhur me prioritetet?

Brikena Ukperaj: Atëherë, meqenëse, lidhur me këtë të fundit, në cilësinë e kryetares, rregullorja ka përfunduar. Draft rregullorja është, në bashkëpunim me përfaqësuesen e Misionit EURALIUS, ka përfunduar, pjesa e rregullores bashkë me metodologjinë dhe tabelën e pikëzimit. Janë duke u reflektuar disa dispozita tranzitore për shkak të debateve, të pikëpamjeve të ndryshme që kemi patur lidhur me se si do të bëhet vlerësimi për gradimin e subjekteve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit dhe si do të gjejë pasqyrim në rregullore dispozita tranzitore e ligjit, të miratuar së fundmi në gusht të vitit 2019, lidhur me procedurat e veçanta që duhet të ndërmarrë Këshilli në kuadër të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, deri në momentin – të vlerësimit, e kam fjalën – deri në momentin kur skema e vlerësimit të funksionojë normalisht. Brenda javës së ardhshme, që është fillimi i tetorit, e gjithë ajo do të dërgohet për mendim anëtarëve të Këshillit dhe gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Meqenëse zonja Ukperaj raportoi për komisionin e saj, mund të raportoj edhe unë për komisionin tonë. Janë bërë gati pjesa më e madhe e relacioneve për kandidatët për formimin fillestar. Besoj që brenda ditës së sotme, ne mund t'jua përcjellim në rrugë elektronike të gjithë anëtarëve.

Për ata që s'ka mbaruar procedura e verifikimit, do të presim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Atëherë, për mbledhjen e ardhshme, dy çështje paraprake që janë për diskutim, janë: inspektorët, statusi i inspektorëve dhe magjistratët. Dhe mirëpres çfarë akte të tjera keni për t'u futur në rendin e ditës (propozimet tuaja).

Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor